



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**  
**DREJTORIA E ÇËSHTJEVE PROCEDURALE, LIGJORE DHE MARRËDHËNIEVE ME JASHTË**

Nr. 589 Prot.

Tiranë, më 15/06/2015

**Lënda :** Dërgohet rekomandim për marrjen e masave për eleminimin e situatës diskriminuese në lidhje me trajtimin me karburant dhe lubrifikanë të personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

**Drejtuar :** **Z. Blendi KLOSI**  
**MINISTËR**  
**MINISTRIA E MIRËQËNIES SOCIALE DHE RINISË**

**TIRANË**


**Znj. Vjollca BRAHO**  
**DREJTORE E PËRGJITHSHME**  
**INSTITUTI I SIGURIMEVE SHOQËRORE**

**TIRANË**

Të nderuar,

Pranë institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), i cili në bazë të ligjit nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, është institucion i cili siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo sjellje që nxit diskriminimin, ka paraqitur një ankesë organizata joftimprurëse, Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar (ADRF).

Kjo organizatë ka parashtruar para KMD-së se, në kuadër të veprimtarisë që ajo ushton në fushën e aftësisë së kufizuar dhe konkretisht në promovimin e shanseve të barabarta dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara me synim përmirësimin e cilësisë së jetës për ta dhe familjet e tyre, ka konstatuar se rregullimi ligjor dhe praktika e ndjekur në lidhje me trajtimin me karburant dhe mjete lubrifikuuese të personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë ka karakter diskriminues. Në kuadër të programeve që kjo organizatë ofron, janë paraqitur dy raste të invalidëve të punës, me status të invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë, konkretisht shtetasit D. Q, banues në Tiranë dhe M.B, banuese në Tepelenë, të cilët janë të interesuar përfitimin e



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë  
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

karburantit për mjetet që ata disponojnë. Të dy këta persona me aftësi të kufizuara (përkatësisht tetraplegji dhe paraplegji), pasi janë interesuar pranë institucioneve kompetente, u është dhënë informacioni që nuk kanë të drejtën përfituar karburant me argumentin se: - ata nuk i kanë zhdoguanuar mjetet e tyre (mjete që janë blerë brenda territorit të Shqipërisë) - që nga viti 2011 të gjithë invalidët e punës e kanë humbur të drejtën e përfitimit të karburantit, pasi tashmë të gjithë invalidët e punës, paraplegjikë dhe tetraplegjikë, ndër të tjera kategori, përfitojnë përjashtimin nga detyrimet doganore dhe taksave dhe për pasojë, procesi i zhdoganimit nuk administrohet nga ISSH për rastet e invalidëve të punës, e si të tillë nuk janë më subjekt shqyrtimi nga ana e këtij institucioni.

ADRF shpjegon se, problematika e hasur ka të bëjë me zhdoganimin e mjeteve, veprim i cili duhet të jetë i lidhur ngushtësisht dhe parakusht për rimbursimin e karburantit. Ndërkohë, edhe pse parashikohen raste të blerjeve të kryera në Shqipëri (pra, pa nevojë çlirimi nga detyrimet doganore në import), sërisht duket sikur kufizon pajisjen me mjete lëvizëse apo autovetura vetëm tek personat që duhet të kryejnë procedurat e zhdoganimit. Ky kusht, i cili parashikohet në Rregulloren nr. 7, datë 24.12.2009 “Për zbatimin e ligjit nr. 7889 datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit të punës, i ndryshuar”, të Këshillit Administrativ të ISSH, i ndryshuar dhe konkretisht interpretimit që i bëhet termit “*administrim*” që parashikohet në pikën 2, të pjesës I-rë, “Përkufizime” të kësaj rregullore, duke e lidhur procesin e administrimit vetëm me procedurat e zhdoganimit, kufizon në mënyrë të palogjikshme përfituesit, pasi i detyron ata të përdorin mjete që duhet të janë detyrimisht objekt i procedurave të zhdoganimit, pra të importuara, me justifikimin se vetëm invalidët që blejnë mjete të zhdoganuara iu lind e drejta përfituar rimbursim për shpenzime karburanti, nga ISSH.

ADRF shton se me ndryshimet që janë bërë në vitin 2011, në ligjin “Për taksat kombëtare”, situata e paqartë ligjore dhe praktika e ndjekur, i kanë hequr të gjithë invalidëve të punës të drejtën përfituar rimbursim për shpenzime karburanti. Vazhdojnë të përfitojnë rimbursim për shpenzime karburanti invalidët e punës, të cilët e kanë përfituar këtë të drejtë para ndryshimit të mësipërm ligjor dhe nuk e përfitojnë të gjithë invalidët e tjerë të cilët kanë hyrë në skemë pas ndryshimeve të vitit 2011. Mungesa e parashikimit dhe mungesa e ndërmarrjes së veprimeve që nga viti 2011, kur është miratuar ndryshimi përkatës në ligjin përfituar rimbursim për kategorinë e personave që futen në skemë, i ka vendosur këta të fundit në një situatë të disfavorshme sa i takon lëvizjes së lirë, integrimit dhe në të gjitha fushat e tjera ku lëvizshmëria mbetet parakusht për realizimin e të drejtave.

Në referim të VKM nr. 723 datë 19.11.1998, i ndryshuar “Për zbatimin e ligjit nr. 7889 datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, përfitojnë rimbursimin e shpenzimeve për blerje karburanteve dhe të lubrikikantëve individët që kanë mjete motorrike dhe janë invalidë të



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë  
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

përcaktuar sipas nenit 1 të ligjit “*Për statusin e invalidit*”. Në këtë vendim nuk ka asnjë parashikim për administrimin e mjeteve apo procedurave të zhdoganimit. Interpretimi i ngushtë, në mënyrë diskriminuese është bërë në rregulloren e ISSH-së.

Një problem tjetër lidhet me situatën e personave me aftësi të kufizuara dhe konkretisht për personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë, por që nuk janë invalidë pune.

Rimbursimi i karburantit parashikohet me VKM nr. 723 datë 19.11.1998, i ndryshuar vetëm për indivitët paraplegjikë dhe tetraplegjikë që janë invalidë pune, pra janë pjesë e skemës së sigurimeve shoqërore. Në këtë mënyrë, përjashtohet kategoria e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë të cilët nuk janë pjesë e kësaj skeme, por janë pjesë e skemës së shërbimit social shtetëror. Ky rregullim ligor sjell një situatë diskriminuese brenda të njëjtës kategori të personave me aftësi të kufizuar, me kushte shëndetësore dhe sociale të ngjashme, por me përfitime të diferencuara.

Bazuar në ligjin “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, në analizë të legjisacionit kombëtar në fuqi dhe atij ndërkombëtar të ratifikuar nga vendi ynë, dhe sa është parashtruar në informacionin e dërguar nga ADRF, Komisioneri, arrin në konkluzionin se **rregullimi ligor dhe praktika e ndjekur në lidhje me trajtimin me karburant dhe mjete lubrifikuuese të personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë ka karakter diskriminues dhe vjen në kundërshtim me parimin e mosdiskriminimit**. Ky konkluzion i arritur nga ana e KMD bazohet në arsyetimin e mëposhtëm:

1. Në bazë të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994, “*Për Statusin e Invalidëve të Punës*”, i ndryshuar, personat që gjëzojnë statusin e invalidit të punës nuk paguajnë taksa doganore për mjetet lëvizëse dhe ndihmëse të përcaktuara në pikën e parë të nenit 8. Sipas pikës 1 të nenit 8, përcaktohet se: “*8.1. Instituti i Sigurimeve Shoqërore administron pajisjen e invalidëve me: a) mjete lëvizëse përfshi dhe autovetura dhe pajisje të ndryshme ortopedike; b) me mjete ndihmëse dëgjimore e pamore speciale; c) me mjete ndihmëse kardiake etj. Kriteret përcaktohen me rregullore të Institutit të Sigurimeve Shoqërore*”.
2. Në bazë dhe për zbatim të nenit 8, pika 1, të ligjit Nr.7889, datë 14.12.1994, “*Për Statusin e Invalidëve të Punës*”, i ndryshuar, është miratuar Rregullorja nr. 7 datë 24.12.2009 e Këshillit Administrativ të ISSH, “*Për zbatimin e ligjit nr. 7889 datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidëve të punës, i ndryshuar”*”. Në pjesën e I-rë, të rregullores dhe konkretisht në pikën 2, jepet kuptimi i termit “*administrim*” në kuptim të nenit 8 të ligjit 7889, duke përcaktuar: *Me termin “administrim”, në kuptim në nenin 8, të ligjit nr. 7889 datë 14.12.1994, “Për statusin e*



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë  
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

*invalidëve të punës”, të punës, sipas të cilit Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH) administron pajisjet e invalidëve, do të kuptohet plotësimi nga ISSH i procedurave që vijojnë:*

- a) për rastet kur blerja e pajisjeve, është financuar nga ISSH-ja ose nga fondet e buxhetit të shtetit ose nga burime të tjera të ligjshme, ISSH merr vendim për pajisjen ose jo të invalidit;
- b) për rastet kur invalidi e ka siguruar vetë mjetin lëvizës, autoveturën etj ( nëpërmjet blerjes, dhurimit apo faljes), ISSH kryen këto procedura: - shqyrton dosjen me dokumentacionin e mjetit lëvizës, autoveturës; dhe - merr vendim nëse invalidi plotëson ose jo kriteret mjekësore për t'u përjashtuar nga taksa doganore.
3. Nga përcaktimi që bëhet në ligjin nr.7889, datë 14.12.1994, “*Për Statusin e Invalidëve të Punës*”, i ndryshuar, në nenin 8.2, kuptohet qartë se që prej vitit 1994 kur është miratuar ligji, personat me statusin e invaliditë të punës kanë gëzuar përjashtimin nga taksat doganore.
4. Rregullorja e ISSH, Nr. 7, datë 24.12.2009, në pikën 2, përcakton se, ka dy variante se si financohen mjetet, sipas nenit 8.1 të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, “*Për Statusin e Invalidëve të Punës*”, i ndryshuar. Varianti i parë është se mjetet mund të financohen nga ISSH ose fondet e buxhetit të shtetit, dhe varianti i dytë është që këto mjete të janë siguruar nga vetë individi.
5. Rasti kur blerja e pajisjes financohet nga ISSH ose buxheti i shtetit është e qartë. Problemi qëndron në procedurën që duhet të ndjekë ISSH në rastin kur pajisja sigurohet nga individi. Rregullorja përcakton se individi e siguron vet mjetin nëpërmjet blerjes apo dhurimit. Në këtë rast administrimi, që kryen ISSH konsiston në kryerjen e këtyre procedurave:
- ISSH shqyrton dosjen me dokumentacionin e mjetit lëvizës, autoveturës;
  - Merr vendim nëse invalidi plotëson ose jo kriteret mjekësore për t'u përjashtuar nga taksa doganore
6. Sipas problematikës që shtrohet, ISSH e konsideron procesin e administrimit të lidhur me procedurat e zhdoganimit. Interpretimi që është bërë nga ISSH është në kundërshtim me ligjin dhe konkretisht nenin 8 të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, “*Për Statusin e Invalidëve të Punës*”, i ndryshuar. Neni 8 nuk e kufizon procesin e administrimit që bëhet nga ISSH vetëm tek mjetet lëvizëse, të cilat kanë nevojë për t'iu nënshkruar procedurave të zhdoganimit.
7. Rregullorja e ISSH, Nr. 7, datë 24.12.2009, në përbajtjen e saj ka kundërshtime. Kështu në pikën 2 të saj, rregullorja nuk e kufizon kuptimin e termit “*administrim*” vetëm te procedurat e zhdoganimit. Këtë e shohim në gjurmën “b” të pikës 2 të rregullores, kur shprehet për rastet



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë  
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

kur individi e ka siguruar vetë mjetin lëvizës, autoveturën, nëpërmjet blerjes, dhurimit<sup>1</sup> dhe përcakton se ISSH kryen procedurat (- shqyrtan dosjen me dokumentacionin e mjetit lëvizës, autoveturës; - merr vendim nëse invalidi plotëson ose jo kriteret mjekësore për t'u përjashtuar nga taksat doganore) dhe në pikën 5 të rregullores përcaktohet se : “**Me dokumentacion të autoveturës, do të kuptohet dokumentacioni i blerjes sipas K.Civil, nëse blerja është kryer në Shqipëri, apo dokumentacioni sipas legjislacionit në fuqi të vendit ku është blerë automjeti.....”.**

8. Pra, sipas pikës 2, gërma “b”, paragrafi i parë, të rregullores, kur kryhet procesi i administrimit për rastet kur personi e siguron vet mjetin lëvizës, dokumentacioni që shqyrtan ISSH, përfshin si rastet kur mjeti i nënshtrohet procesit të zhdoganimit, ashtu eshte rastet kur mjeti është blerë në Shqipëri dhe nuk ka nevojë ti nënshkrohet zhdoganimit. Në vijim të kësaj rregullore dhe procedurave që përcaktohen për ISSH, është harruar pjesa e detyrave që ISSH duhet të përbushë si pjesë e procesit të administrimit që ligji i ka ngarkuar dhe që gjithashtu del edhe nga pjesa e parë e rregullores pikat 2 dhe 5 të saj. Rregullorja në pjesët vijuese të saj trajton vetëm procedurat që duhet të ndiqen kur mjeti financohet nga ISSH-ja ose buxheti i shtetit dhe procedurat për rastet kur mjeti është siguruar jashtë vendit dhe kërkohet zhdoganimi i tij. Rregullorja nuk ka parashikime në lidhje me procesin e administrimit për rastet kur mjeti sigurohet brenda vendit dhe nuk ka nevojë ti nënshkrohet procesit të zhdoganimit.
9. **Sa më sipër, procedura e ndjekur nga ISSH, duke mos marrë në shqyrtim kërkosat e personave me justifikimin se ajo admininstron vetëm rastet kur mjetet i nënshtrohen procedurave të zhdoganimit, vlerësojmë se bien në kundërshtim me nenin 8 të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, “*Për Statusin e Invalidëve të Punës*”, i ndryshuar, por edhe me pikat 2 dhe 5 të Rregullores Nr. 7, datë 24.12.2009, të Këshillit Administrativ të Institutit të Sigurimeve Shoqërore.**
10. Në pamje të parë duket sikur procesi i administrimit që kryhet nga ISSH për mjetet lëvizëse të personave që gjëzojnë statusin e invalidit të punës, nuk paraqet ndonjë kufizim në përfitimet që ju garantohen nga ligji, pasi procesi i administrimit i interpretuar si i lidhur me procedurat e zhdoganimit të mjetit, nuk ka ndonjë rëndësi për mjetet që këtë persona sigurojnë vet, por që janë të blera apo dhurura në Shqipëri. Por, duke ju referuar akteve nënligjore që kanë dalë në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 7889 datë 14.12.1994 “*Për statusin e invalidëve të punës*”, i ndryshuar, vëmë re se procesi i administrimit që realizohet nga ISSH është i lidhur me të

---

<sup>1</sup> Nga pikëpamja juridike termi “falje” që përdoret në këtë pikë është i papërshtatshëm dhe nuk ka kuptim.



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë  
 (Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
 Tel: +355 4 2431078  
 Fax: +355 4 2431077  
 e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
 web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

drejtën për të përsituar karburant. Konkretisht, është miratuar VKM nr. 723 datë 19.11.1998, i ndyshuar “*Për zbatimin e ligjit nr. 7889 datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”*”. Në pikën 1 dhe 2 të VKM-së, përcaktohet se : “*1. Përfitojnë rimbursimin e shpenzimeve për blerjen e karburanteve dhe te lubrifikanteve, invalidët që kanë mjete motorike për invalidë. 2. E drejta e invalidëve për të përsituar rimbursimin e shpenzimeve, për blerjen e karburanteve dhe të lubrifikanteve, përcaktohet nga komisionet mjekësore të caktimit të aftësisë për punë, pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe organeve rajonale në varësi të tij, sipas kritereve të përcaktuara nga ky Institut.....”*

11. Duke ju referuar VKM-së nr. 723, datë 19.11.1998, i cili, ashtu si edhe Rregullorja e ISSH-së nr. 7 datë 24.12.2009, ka dalë për zbatimin e ligjit nr. 7889 datë 14.12.1994, “*Për statusin e invalidit*”, të ndryshuar, personat që kanë statusin e invalidit të punës përfitojnë rimbursimin e shpenzimeve për blerjen e karburanteve dhe të lubrifikantëve dhe se përgjegjëse për të shqyrtaar kërkuesat nga subjektet që e gjëzojnë këtë të drejtë, janë komisionet mjekësore të caktimit të aftësisë për punë, pranë Institutit te Sigurimeve Shoqërore dhe organeve rajonale në varësi te tij, sipas kritereve të përcaktuara nga ky institut. Referuar Rregullores nr. 7 datë 24.12.2009 të Këshillit Administrativ të ISSH, janë po këto komisione mjekësore ato që shqyrtojnë dokumentacionin dhe bëjnë rekomandimin pranë ISSH.
12. Edhe pse nuk citohet në bazën ligjore të VKM nr. 723 datë 19.11.1998, i cili ka dalë në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 7889 datë 14.12.1994, “*Për statusin e invalidit*”, të ndryshuar, nga përbajtja e ligjit kuptohet qartësish se, kjo VKM ka dalë për zbatim të nenit 8 të ligjit, pasi VKM-ja përcakton rimbursimin e karburantit për mjetet motorrike për invalidë, mjete të cilat përcaktohet se administrohen nga ISSH pikërisht nga ky nen i ligjit. Ky nen i ligjit ka autorizuar gjithashtu ISSH për të përcaktuar me rregullore kriteret në lidhje me administrimin procesit të pajisjes së invalidëve me mjetet e përcaktuara në pikën 1 të nenit 8 të ligjit. Sa më sipër, rezulton se ISSH me rregullore ka deformuar duke kufizuar procesin e administrimit të mjetave lëvizëse për këta persona, duke e lidhur procesin e administrimit vetëm me zhdoganimin e mjeteve.
13. VKM nr. 723, datë 19.11.1998 nga ana tjeter ngarkon ISSH që të përcaktojë kriteret për te përsituar rimbursimin e shpenzimeve për blerjen e karburanteve dhe te lubrifikanteve, duke i ngarkuar në këtë mënyrë këtij institucioni detyrën për të shqyrtaar kërkuesat e individëve që ju jepet kjo e drejtë.
14. Sipas interpretimit që bëhet nga ISSH, që të përfitosh rimbursimin e shpenzimeve për blerjen e karburanteve dhe të lubrifikanteve, si një e drejtë që i njihet personave që kanë statusin e invalidit të punës, duhet që mjetin e siguruar vet ta kesh blerë jashtë shtetit, pasi vetëm ato



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë  
 (Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
 Tel: +355 4 2431078  
 Fax: +355 4 2431077  
 e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
 web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

mjete që i nënshtrohen procesit të zhdoganimit, administrohen nga ISSH. Pra, zhdoganimi i mjeteve është parakusht për rimbursimin, ndërkokë që VKM nr. 723 që njeh të drejtën për rimbursimin e shpenzimeve për blerjen e karburanteve dhe te lubrifikanteve, nuk e kushtëzon këtë përsitim me ndonjë procedurë për administrimin e mjeteve apo procedurë zhdoganimi. Vlen të theksohet se vendimi i Këshillit të Ministrave është një akt që qëndron më lart në hierarkinë e normave se sa rregullorja e ISSH-së.

15. **Praktika e ndjekur nga ISSH duke e konsideruar procesin e zhdoganimit si parakusht për rimbursimin e karburantit është në kundërshtim me ligjin, me VKM-në nr. 723 datë 19.11.1998, dhe ka karakter përjashtues për gjëzimin e përsitimeve që ligji u njeh personave që kanë statusin e invalidit të punës dhe që plotësojnë kriteret e përcaktuara mjekësore.**
16. Me ligjin Nr.10 458, datë 21.07.2011 “*Për disa ndryshime në ligjin nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar, janë bërë disa ndryshime në nen 9, të ligjit “Për taksat kombëtare”, ndryshime që lidhen me të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në përgjithësi dhe përjashtimin e tyre nga pagimi i taksës së mjeteve të përdorura të transportit në import dhe në shitje, sipas përcakttimeve që bëhen në këtë dispozitë. Sipas shpjegimeve të ADRF, ISSH nuk administron më mjete, pasi ato apriori sipas pretendimeve të ISSH, tashmë janë të përjashtuara. Sipas ADRF, me këto ndryshime ligjore, praktika e ndjekur nga ISSH, i ka hequr të drejtën përfituar të gjithë invalidët e punës. Vazhdojnë të përfitojnë nga kjo e drejtë invalidët e punës të cilët e kanë përfituar para ndryshimeve ligjore dhe ndërkokë nuk përfitojnë invalidët e tjera të cilët kanë hyrë në skemë pas ndryshimeve të ndodhura.*
17. Në momentin e miratimit të ligjit nr. 9975 datë 28.07.2008 “*Për taksat kombëtare*”, nen 9, ka patur këtë përbajtje :\_ “ 1. *Përjashtohen nga pagimi i taksës vjetore të qarkullimit rrugor të mjeteve: ..... c) invalidët tetraplegjikë, që e fitojnë këtë status, në bazë të ligjeve përkatëse, kur mjeti është në zotërimin e tyre dhe përdoret vetëm për nevojat e tyre vetjake dhe jo për veprimtari private. Sipas nenit 16/1 të ligjit nr.7889 datë 14.12.1994 "Për statusin e invalidit" dhe të nenit 4 të ligjit nr.8098, datë 28.3.1996 "Për statusin e të verbit", kur invalidi i punës dhe personi i verbër ushtrojnë veprimtari private, nuk përjashtohen nga pagimi i kësaj takse. 2. Përjashtohen nga pagimi i taksës së mjedisit, për komponentin e taksës së importimit të mjeteve të përdorura, invalidët dhe veteranët e luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar, invalidët e punës, të verbit, invalidët përaplegjikë dhe tetraplegjikë, që e fitojnë këtë status, në bazë të ligjeve përkatëse, kur mjeti importohet për zotërimin e tyre dhe përdoret vetëm për nevojat e tyre vetjake dhe jo për veprimtari private. ....”*



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë  
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

18. Me nenin 5, të ligjit nr. Nr.10 280, datë 20.5.2010 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 9975, datë 28.7.2008 "Për Taksat Kombëtare", të ndryshuar, neni 9, ka pësuar këto ndryshime: "Përjashtimet nga pagimi i taksave kombëtare" ndryshohet si më poshtë: "2. Përjashtohen nga pagimi i taksës së mjeteve të përdorura të transportit, në import dhe në shitje, autoveturat tip 4 + 1 vende dhe me cilindratë jo më shumë se 2500 kubikë, kur këto mjete kalojnë në zotërim të invalidëve e të veteranëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar, invalidëve të punës, të verbërve, invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë që e fitojnë këtë status në bazë të ligjeve përkatëse dhe përdoren vetëm për nevojat e tyre personale dhe jo për veprimtari private."
19. Me nenin 6, të ligjit nr. Nr.10 458, datë 21.07.2011 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 9975, datë 28.7.2008 "Për Taksat Kombëtare", të ndryshuar, neni 9 ka pësuar këto ndryshime: "Përjashtohen nga pagimi i taksës vjetore të mjeteve të përdorura: ..... ç) autoveturat tip 4+1 vende dhe me cilindratë jo më shumë se 2500 kubikë, kur këto mjete kalojnë në zotërim të invalidëve e të veteranëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar, invalidëve të punës, të verbërve, invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë, që e fitojnë këtë status në bazë të ligjeve përkatëse, dhe përdoren vetëm për nevojat e tyre personale e jo për veprimtari private; d) makinat bujqësore."
20. Që në miratimin e tij ligji nr. 9975 datë 28.07.2008 "Për taksat kombëtare" ka patur të parashikuar se invalidët e punës ashtu si edhe disa kategori të tjera, janë të përjashtuar nga taksa e importimit të mjeteve. Për më tepër, nga përcaktimi që bëhet në ligjin nr. 7889 datë 14.12.1994 "Për statusin e invalidit", në nenin 8.2, kuptohet qartë se që prej vitit 1994 kur është miratuar ligji personat me statusin e invaliditë të punës kanë gëzuar përjashtimin nga taksat doganore. Sa më sipër, konstatohet se nuk ka ndodhur ndonjë ndryshim në 2011, siç pretendohet, ndryshim i cili do të sillte ndryshime në praktikën e ndjekur nga ISSH. Megjithatë, pavarësisht ndryshimeve apo jo në ligjin "Për taksat kombëtare", ligji bazë i cili u njeh të drejtën personave me statusin e invalidit të punës që është ligji nr. 7889 datë 14.12.1994 "Për statusin e invalidit" u ka njojur të drejtën përtu përjashtuar nga detyrimet doganore që prej vitit 1994. Po ky ligj, ngarkon ISSH me procesin e administrimit të pajisjeve të personave që gëzojnë statusin e invalidit të punës, dhe një detyrim i tillë nuk rezulton të ketë ndryshuar.
21. **Sa më sipër, jo vetëm që rezulton e pabazuar në ligj, por njëkohësisht një praktikë e tillë cënon haptazi qëllimin e ligjit "Për statusin e invalidit", i cili synon integrimin në shoqëri të këtyre personave, por edhe me parimet e jetesës së pavarur për personat me**



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë  
 (Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
 Tel: +355 4 2431078  
 Fax: +355 4 2431077  
 e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
 web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

aftësi të kufizuara të sanksionuar në Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, e cila është pjesë e legjislacionit tonë të brendshëm, e detyrueshme për tu zbatuar pasi është ratifikuar nga Kuvendi me ligjin nr. Nr. 108/2012 “*Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”*”.

22. E gjithë problematika e krijuar për të përfituar rimbursimin e karburantit që i'u njihet invalidëve të punës në bazë të VKM-së 723, datë 19.11.1998, i ndyshuar, vjen pasi ISSH e kufizon detyrimin e saj të përcaktuar me ligj por edhe me aktet e tjera nënligjore të dala në bazë dhe për zbatimin të ligjit me marrjen e vendimit nga ISSH që lejojnë ose jo perjashtimin nga taksat doganore.
23. Në bazë të VKM-së 723, datë 19.11.1998, i ndyshuar, personave me statusin e invalidit iu lind e drejta e përfitimit të karburantit dhe lubrifikantëve. Ky akt nënligjor ngarkon komisionet mjekësore pranë ISSH për të shqyrtuar kërkesat dhe vetë ISSH të përcaktojë kriteret. Në këtë kushte refuzimi i ISSH për të shqyrtuar kërkesat e individëve për të përfituar të drejtën e rimbursimit, është i pabazuar, në kundërshtim me ligjin, pasi ISSH është duke mos përbushur detyrat të cilat i janë ngarkuar me ligj dhe akte nënligjore.
24. **Sa më sipër lind nevoja që në mënyrë urgjente të ndryshohet praktika e ISSH, e cila refuzon marrjen në shqyrtim të kërkesave të individëve, të cilët kanë përfituar statusin e invalidit të punës që prej ndryshimeve të ndodhura në ligjin “*Për taksat kombëtare*” në vitin 2011 dhe të cilët aplikojnë për të përfituar rimbursimin e karburantit dhe lubrifikantëve sipas VKM-së nr. 723.** Procesi i përfitimit të rimbursimit të karburantit nuk duhet të konsiderohet i kushtëzuar nga procesi i zhdonimit të automjetit apo pajisjes që personi me statusin e invalidit të punës ka, por është një e drejtë e pavarur që u njihet atyre nga VKM 723. Kjo VKM, ngarkon ISSH me përcaktimin e kritereve përkatëse dhe është pikërisht kjo që ISSH duhet të bëjë në lidhje me rimbursimin e karburantit për të gjitha pajisjet apo automjet e personave me statusin e invalidit të punës, dhe jo vetëm për ato që i janë nënshtruar procesit të zhdonimit. Pra, përfundimisht ISSH duhet të shqyrtojë kërkesat për rimbursimin e karburantit sipas kritereve të përcaktuara prej saj për të gjithë invalidët e punës pavarësisht nga momenti i hyrjes së tyre në skemë, pra nga momenti i përfitimit nga ana e tyre e statusit të invalidit dhe pavarësisht nga mënyra se si ata e kanë siguruar automjetin apo pajisjen që kanë, e kanë importuar apo e kanë blerë brenda vendit.
25. Ligji u ka njojur këto të drejta të gjithë invalidëve që kanë statusin e invalidit të punës për shkak të nevojave që ata kanë dhe kritereve mjekësore, kritere këto që janë thelbësore për të përfituar mbështetjen që ligji u ka akorduar. Nevojat e invalidëve me statusin e invalidit të



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë  
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

punës që e kanë blerë automjetin apo pajisjen në vend apo nevojat e invalidëve që kanë hyrë në skemë duke përfituar statusin pas ndryshimeve në ligjin “*Për taksat kombëtare*”, nuk ndryshojnë aspak me nevojat e atyre personave që kanë statusin e invalidit, por që e kanë siguruar automjetin duke e importuar, apo kanë hyrë në skemë para ndryshimeve të ligjit “*Për taksat kombëtare*”, duke plotësuar nga ana tjeter për të gjitha këto kategori kriteret përkatëse mjekësore. **Këto praktika janë haptazi përjashtuese dhe diskriminuese.**

26. Konventa e OKB-së “*Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara*”, pranon diversitetin e personave me aftësi të kufizuara. Konventa ka *pranuar se aftësia e kufizuar* është një koncept evolues dhe se aftësia e kufizuar rezulton nga ndërveprimi ndërmjet personave me dëmtime dhe barrierave të qëndrimit/mentalitetit dhe ambientit, që pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në nivel të barabartë me të tjerët. Ky përcaktim synon gjithpërfshirjen dhe jo përjashtimin. Nga ana tjeter, një nga parimet themelore të kësaj konverte është parimi i mosdiskriminimit. Ky parim ka të bëjë jo vetëm me mosdiskriminimin e personave me aftësi të kufizuara në raport me personat e tjerë, por edhe brenda kategorive të ndryshme të aftësisë së kufizuar.
27. Bazuar në VKM 723 datë 19.11.1998, pika 1, e tij, parashikohet se: “*Përfitojnë rimbursimin e shpenzimeve për blerjen e karburanteve dhe të lubrifikanenteve, invalidët që kanë mjete motorike për invalidë*.”. Sa rezulton nga praktika e ndjekur nga ISSH, rimburimi i karburanteve dhe lubrifikantëve, iu është dhënë vetëm invalidëve të punës të cilët janë paraplegjikë dhe tetraplegjikë.
28. Legjislacioni aktual mbështetjen për integrimin në shoqëri të disa kategorive të aftësisë së kufizuar e ka bërë nëpërmjet disa ligjeve, të cilat u kanë dhënë këtyre kategorive të personave me aftësi të kufizuara statuse dhe përfitime të caktuara që rrjedhin prej tyre. Një nga këto ligje është ligji nr. 8626 datë 22.06.2000 “*Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik*”. Nga ky ligj përfitojnë të gjithë invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, pavarësisht nga mosha, koha, vendndodhja e aksidentit dhe çasti i sigurimit. Në bazë të nenit 16 të ligjit përcaktohet se: “*Administrata e Përgjithshme e Ndihmës dhe e Shërbimeve Sociale administron mjetet e përshtatura për të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë. Kriteret përcaktohen me rregullore nga Administrata e Përgjithshme e Ndihmës dhe e Shërbimeve Sociale. Personat e sëmurë paraplegjikë dhe tetraplegjikë përjashtohen nga taksat doganore për mjete, të cilat ndihmojnë në integrimin e tyre në jetë, përfshirë këtu dhe autovetura të përshtatura për përdorim prej tyre.*” Referuar këtij neni, ndryshe nga invalidët e punës, për të cilët procesi i administrimit të pajisjeve bëhet nga ISSH, për personat që kanë statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, ky proces bëhet nga Shërbimi Social Shtetëror, i cili është një institucion në varësi të Ministrisë së Mirëqënieve Sociale dhe Rinisë. E megjithatë problematikat e mësipërme të



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë  
 (Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
 Tel: +355 4 2431078  
 Fax: +355 4 2431077  
 e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
 web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

individëve që gjëzojnë statusin e invalidit të punës dhe individëve që gjëzojnë statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, hyjnë në fushën e veprimtarisë së Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

29. Personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë që përfitojnë statusin në bazë të ligjit nr. 8626 datë 22.06.2000 “*Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik*”, të ndryshuar, padyshim që kanë të njëjtat kushte shëndetësore dhe kanë të njëjtat nevoja për mbështetje me individët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të cilët janë invalidë pune dhe që përfitojnë në bazë të ligjit nr. 7889 datë 14.12.1994 “*Për statusin e invalidit*”, të ndryshuar. Por, individët paraplegjikë dhe tetraplegjikë që përfitojnë statusin në bazë të ligjit nr. 8626 datë 22.06.2000 “*Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik*”, nuk përfitojnë të drejtën për t'u rimbursuar për karburant apo mjetet lubrifikuese për mjetet që ata disponojnë, ndryshe nga personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë që kanë statusin e invalidit të punës sipas ligjit ligjit nr. 7889 datë 14.12.1994 “*Për statusin e invalidit*”. Në këtë mënyrë brenda të njëjtës kategori të personave me aftësi të kufizuar, pra persona paraplegjikë dhe tetraplegjikë, përfitimet janë të diferencuara, duke sjellë në këtë mënyrë një situatë diskriminuese. Mungesa e legjislacionit ka bërë që përvite me radhë të ekzistojnë këto diferenca midis të njëjtës kategori të personave me aftësi të kufizuar.
30. Sa më sipër kërkohet marrja e nismave urgjente nga ana e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për të bërë të mundur që katëgoritë e personave me aftësi të kufizuara paraplegjikë dhe tetraplegjikë, pavarësisht nëse ata kanë statusin e invalidit të punës sipas ligjit 7889 datë 14.12.1994 apo statusin si invalid paraplegjik dhe tetraplegjik sipas ligjit nr. 8626 datë 22.06.2000, të marrin të njëjtat përfitime nga ana e shtetit. Plotësimi i legjislacionit në këtë drejtim do të elemionte në këtë mënyrë efektin diskriminues që vjen nga legjislacioni aktual në fuqi.

Bazuar në Ligjin nr. 10 221 datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, nenin 3, pikat 2 e 3, neni 20, pikat 1 e 2, dhe në bazë të kompetencës së Komisionerit të përcaktuara në neni 32, pika 1, gërmë “ë”, ku parashikohet se: “*1. Komisioneri ka kompetencë:.....ë) t'u bëjë rekomandime autoriteteve kompetente, sidomos duke propozuar miratimin e legjislacionit të ri, ose ndryshimin apo reformimin e legjislacionit ekzistues;.....*”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

## REKOMANDON

1. Ndryshimin e menjëhershëm të procedurave të ndjekura nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe marrjen në shqyrtim të kërkesave të personave paraplegjikë dhe traplegjikë



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë  
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

që kanë statusin e invalidit të punës edhe për rastet kur mjeteti nuk i nënshtrohet procedurave të zhdoganimit, por mjeti është blerë apo dhuruar brenda territorit të vendit.

2. Ndryshimin e menjëhershëm të procedurave të ndjekura nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe marrjen në shqyrtim të kërkesave për reimbursimin e karkurantit dhe lubrifikantëve sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 723, datë 19.11.1998 të personave paraplegjikë dhe traplegjikë që e kanë fituar statusin e invalidit të punës pas ndryshimeve të vitit 2011, të ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 "Për Taksat Kombëtare", i ndryshuar.
3. Të rishikohet Rregullorja Nr.7, datë 24.12.2009 e Këshillit Administrativ të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, me qëllim plotësimin e saj procedurat që duhen ndjekur për vendimarrjen nga ana e ISSH-së për rastet kur mjetet e personave që gjëzojnë statusin e invalidit të punës nuk kanë nevojë për procesin e zhdoganimit pasi janë siguruar brenda vendit si dhe qartësimin e rregullores për shëmangien e interpretimeve diskriminuese të saj.
4. Të përcaktohen rregulla dhe kritere të qarta për mënyrën e përfitimit të reimbursimit të shpenzimeve për blerjen e karburantit dhe lubrifikantëve, sipas pikës 2, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. Nr. 723, datë 19.11.1998.
5. Marrjen e nismave urgjentë nga ana e Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë për plotësimin e legjislacionit me qëllim bërjen të mundur që katëgoritë e personave me aftësi të kufizuar paraplegjikë dhe tetraplegjikë, pavarësisht nëse ata kanë statusin e invalidit të punës sipas ligjit 7889 datë 14.12.1994 apo statusin si invalid paraplegjik dhe tetraplegjik sipas ligjit nr. 8626 datë 22.06.2000, të marrin të njëjtat përfitime nga ana e shtetit.

Ju lutemi të na informoni brenda një afati të arsyeshëm lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij rekomandimi.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin.

#### KOMISIONERE

Irma BARAKU  
Në mungesë dhë me porosi



#### DREJTORE DREJTORIE

Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë  
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

